

## Vendim nr. 212 datë 01.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 01.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 32 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **ARBEN DEDA**, përfaqësuar nga avokatët Fabjon Murrizi dhe Arlind Ahmetaj, me autorizim.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-2022, datë 07.12.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 29, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

## Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 2015 kërkuesi Arben Deda është proceduar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal (KP). Sipas prokurorisë, kërkuesi gjatë ushtrimit të detyrës së oficerit të policisë gjyqësore ka përpiluar aktin e kallëzimit të një shtetaseje për veprën penale të dhunës në familje dhe ka paraqitur fakte të pavërteta në atë akt.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. 62-2017-4931 (587), datë 20.10.2017 ka vendosur deklarinim fajtor të kërkuesit sipas akuzës duke e dënuar me 200 orë punë në interes publik, për një periudhë prej 6 muajsh dhe me ndalimin e ushtrimit të funksioneve publike për 1 vit e 6 muaj.

3. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 474, datë 18.09.2018, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2022, datë 07.12.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

4. Në datën 18.07.2024 kërkuesi i është drejtuar, nëpërmjet shërbimit postar, Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 22.07.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimi i Gjykatës së Lartë i është cenuar:

5.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

5.1.1. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi arsyetimi i Gjykatës së Lartë është formalist duke mos i kthyer përgjigje pretendimit të tij kryesor se është dënuar pa ligj duke dhënë pa asnjë arsye se për se cilësimi ligjor i faktit penal ishte i drejtë. Ajo gjykatë ka konkluduar *apriori* se vendimet që e kanë deklaruar atë fajtor janë të bazuara dhe të marra në përputhje me ligjin.

5.1.2. *E drejta e aksesit efektiv*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka siguruar atij një mjet ankimor efektiv, duke i krijuar pasoja negative reale dhe të drejtpërdrejta.

5.2. E drejta për të mos u dënuar pa ligj, e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, pasi nuk ekzistojnë elementet e veprës penale, të parashikuar nga neni 186 i KP-së.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuësit

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë kuptim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kundërshton procesin gjyqësor në të cilin është vendosur për akuzën penale ndaj tij, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

9. Po kështu, Kolegji vë në dukje se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar në formë dhe substancë pretendimet e parashtruara, ndaj, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ai ka përmbushur edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion*.

10. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, momenti i konstatimit të cenimit të së drejtës llogaritet data e marrjes dijeni të vendimit të arsyetuar, i cili nëse palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit duhet t'i njoftohet elektronikisht atyre (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen konkrete, Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 07.12.2023 dhe është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 18.03.2024. Sekretaria e Gjykatës së Lartë i ka komunikuar kërkuesit kopje të vendimit nëpërmjet postës elektronike në datën 19.03.2024. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

12. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe aksesit efektiv, si dhe të drejtën e mosdënimit pa ligj, të garantuara nga nenet 29, 42 dhe 43 të Kushtetutës. Këto pretendime *prima facie* janë me natyrë kushtetuese, ndaj Kolegji do t'i analizojë në vijim.

13. Kërkuesi ka parashtruar se arsytimi i Gjykatës së Lartë është formalist duke mos i kthyer përgjigje pretendimit se ai është dënuar pa ligj. Sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i KP-së, por ka konkluduar *apriori* se vendimet që e kanë deklaruar atë fajtor janë të drejta dhe të marra në përputhje me ligjin. Në këtë mënyrë, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk i ka siguruar atij një mjet ankimor efektiv.

14. Gjykata ka theksuar se arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Me arsytimin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se kur kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa i takon së drejtës së aksesit efektiv, Gjykata ka pranuar se kur në rekurs janë ngritur pretendime, të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme dhe kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për to, për shkak të vendimit të mospranimin të rekursit, kjo përbën cenim të së drejtës themelore për proces të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, aksesin në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 58, datë 13.11.2023; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se pretendimi kryesor i kërkuesit gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme lidhet me faktin që procesverbali i kallëzimit ishte nënshkruar edhe nga vetë kallëzuesja dhe se, ai në cilësinë e oficerit të Policisë Gjyqësore kishte vendosur ekspertimin mjekoligjor të kallëzueses, ndaj nuk kishte pasur për qëllim të përpilonte një kallëzim të pavërtetë.

17. Gjykata e shkallës së parë, pasi ka analizuar provat, ka konkluduar se kërkuesi, në cilësinë e oficerit të Policisë Gjyqësore, si person i ngarkuar nga ligji për përpilimin e procesverbalit për kallëzimin e veprës penale, që përbën dokument zyrtar, me veprime aktive ka falsifikuar procesverbalin e ankimit me gojë të të dëmtuarës, duke mos pasqyruar ankimin e vërtetë të saj për dëmtimet e shkaktuara, por rrethana dhe të dhëna që nuk i përgjigjen të vërtetës. Për rrjedhojë, sipas gjykatës, ai ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 186 i KP-së nga personi që ka për detyrë të lëshojë aktin dhe për këtë duhet të deklarohet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

18. Ky arsytim është mbështetur edhe nga gjykata e apelit, e cila i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet në ankim të kërkuesit, duke argumentuar se e dëmtuara ka pasur një gjendje të rënduar psikologjike dhe në ato rrethana që është ndodhur, përballë edhe sjelljes së kërkuesit i cili, sipas saj, i bënte vazhdimisht presion për përgjegjësi penale, e ka nënshkruar procesverbalin e kallëzimit pa lexuar përmbajtjen e tij. Po kështu, sipas gjykatës së apelit, pretendimi i kërkuesit mbi përpilimin prej tij të vendimit për kryerjen e aktit të ekspertimit mjekoligjor për dëmtimet që kishte pësuar e dëmtuara, jo vetëm që nuk përbën rrethanë që provon përmbushjen e rregullt të detyrës në lidhje me pasqyrimin e drejtë të pretendimeve të dëmtuarës, por përbën edhe një kontradiktë në qëndrimin e tij. Pikërisht, për shkak të këtyre pretendimeve të të dëmtuarës për dhunë fizike ndaj saj, ka lindur nevoja që të kryhej ky ekspertim dhe për këtë rrethanë kërkuesi kishte detyrimin të kërkonte sqarime të hollësishme prej saj, qoftë edhe për të pasqyruar në aktin procedural të kallëzimit çdo përshkrim për dëmtimet që ajo pretendonte. Aq më tepër edhe evidentimi që ai ka pasqyruar në aktin procedural të kallëzimit, ku sipas kallëzueses, është dëmtuar për shkak të rrëzimit të saj, është sa alogjik aq edhe kontradiktor me vetë paraqitjen e këtij kallëzimi, pasi mbetet pa shpjegim se çfarë ka dashur të realizojë kallëzuesja nëpërmjet këtij akti kur ka pranuar se është vetëdëmtuar për shkak të rrëzimit të saj. Në konkluzion, gjykata e apelit e ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë që e ka gjetur të provuar akuzën në ngarkim të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/3 i KP-së, duke e lënë në fuqi atë.

19. Në vijim, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se vendimet e gjykatave të faktit janë të argumentuara si në lidhje me ekzistencën e faktit penal dhe rrethanat e çështjes në tërësi, me vlerësimin dhe çmuarjen e provave të marra e të verifikuara në këtë proces penal, ashtu edhe në lidhje me cilësimin ligjor të faktit penal për të cilin është akuzuar kërkuesi në përputhje me nenin 152 të KPP-së. Sipas saj, në vendimmarrjen e gjykatës së apelit, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural penal me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; nuk konstatohen shkelje procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; si dhe nuk rezulton që vendimi të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, referuar shkaqeve të rekursit të parashikuar nga neni 432 i KPP-së. Në përfundim, ajo gjykatë ka vendosur mospranimin e rekursit për shkaqe ligjore.

20. Për sa më lart, Kolegji konstaton se në të kundërt me sa pretendon kërkuesi, në ankimin kushtetues individual të tria gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, kanë arsyetuar mjaftueshëm për sa i takon rrethanave të ngjarjes, veprimeve dhe sjelljes së tij lidhur me të. Ato kanë arsyetuar qëndrimin e tyre, duke analizuar të gjitha elementet e veprës penale për të cilat ai ka qenë i akuzuar, si në aspektin objektiv, ashtu edhe në atë subjektiv, duke i dhënë përgjigje shteruese faktit se kërkuesi ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe se dënimi i tij është mbështetur në ligj dhe në prova. Po kështu, Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj ka treguar se për shqyrtimin e shkaqeve të rekursit është mbështetur në materialet e dosjes gjyqësore, e cila sikurse rezulton edhe nga arsyetimi i dy gjykatave të faktit, përmban akte dhe dokumente të shkruara, të administruara në cilësinë e provës, përfshirë edhe dëshmitë dhe ballafaqimet mes kërkuesit, të dëmtuarës dhe personave që kanë pasur dijeni për ngjarjen, të dhëna gjatë hetimit dhe gjatë gjykimit të çështjes. Ndaj Gjykata e Lartë, pasi ka analizuar vendimmarrjen e gjykatës së apelit në raport me të dhënat e dosjes gjyqësore dhe shkaqet e rekursit ka vlerësuar se ato nuk janë të tilla që të cenojnë atë vendim, duke disponuar mospranimin e rekursit, ndaj pretendimet për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit dhe të aksesit efektiv janë haptazi të pabazuara.

21. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se procesverbali i kallëzimit të veprës penale përbën akt zyrtar, i cili përpilohet nga oficeri i Policisë Gjyqësore që ushtron veprimtari publike dhe përbën provë të plotë të deklarimeve të bëra përpara tij, megjithatë kur pretendohet se ai është i falsifikuar lejohet të provohet e kundërta (neni 253 i Kodit të Procedurës Civile). Në këtë pikëpamje, falsiteti i kallëzimit në rastin konkret dhe pretendimi i kërkuesit për dënimin pa ligj, në thelb, ka të bëjë me procesin e të provuarit që kanë zhvilluar gjykatat e faktit. Ashtu siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, çështja e vlerësimit, dobishmërisë dhe rëndësisë së provave në një

çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

22. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuarit janë haptazi të pabazuara, ndaj ankimi kushtetues individual i tij nuk është i pranueshëm në këndvështrim të kriterit *ratione materiae*, rrjedhimisht çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.